



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 201

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 27 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 108, datë 14.11.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar..	21951
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 27.11.2024	Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	21951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 20.11.2024	Për bazën e të dhënave shtetërore “Sistemi i menaxhimit të informacionit <i>e-aktel</i> ”	21951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 27.11.2024	Për lirim nga detyra.....	21953
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 27.11.2024	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024.....	21953

**VENDIM**
Nr. 108/2024**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN**
NR. 69/2021, “PËR ÇAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në pikën I, të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Deputeti Andrea Mano caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 14.11.2024.

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 27.11.2024**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN**
NR. 29/2023, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Pas pikës 5, të nenit 69, “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Parapagimet/këstet e paguara apo të gjeneruara në zbatim të nenit 63, të këtij ligji, nga të vetëpunësuarit, si dhe entitetet me të ardhura bruto deri në 14 milionë lekë në vit, të cilat furnizojnë shërbime profesionale sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 4, dhe tabelës analitike nr. 2, të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të shfuqizuar me vendimin nr. 52, datë 27.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, u rimbursohen tatimpaguesve apo u fshihen nga administrata tatimore, brenda datës 30 dhjetor 2024.

Shuma e kësteve të paguara do të pasqyrohet te klasa përkatëse e të ardhurave dhe, nëpërmjet degës së thesarit, administrata tatimore kryen rimbursimin në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Drejtori i përgjithshëm i Tatimeve, me akt të brendshëm, miraton rregullat procedurale për zbatimin e kësaj pike.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 710, datë 20.11.2024**PËR BAZËN E TË DHËNAVE**
SHTETËRORE “SISTEMI I
MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT
E-AKTET”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për bazën e të dhënave shtetërore “Sistemi i menaxhimit të informacionit *e-aktet*” (në vijim, “*e-aktet*”).

2. *E-aktet* ka si qëllim ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave në formë elektronike për projektaktet dhe dokumentet shoqëruese *on-line* të



institucioneve shtetërore, duke i grupuar sipas linjës hierarkike të miratimit të tyre, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

3. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore *e-aktet* është Këshilli i Ministrave.

4. Lista e institucioneve dhe e organeve në sistemin *e-aktet* përbëhet nga ministritë dhe ministrat e shtetit, sipas përbërjes së Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet e varësisë së tij. Lista e institucioneve të varësisë në sistemin *e-aktet* përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në varësi të shkallës së përfshirjes që ato kanë për dhënien e mendimit për projektaktet. Funksionet e punonjësve në këtë sistem përcaktohen sipas detyrave që ata ushtrojnë gjatë procesit të hartimit, bashkërendimit, dhënies së mendimit apo shqyrtimit të projektaktit, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

5. Në *e-aktet* regjistrohen nëpunës dhe titullarë të institucioneve propozuese dhe mendimdhënëse për projektaktet ligjore e nënligjore, sipas pikës 4, të këtij vendimi.

6. Të dhënat që përmban *e-aktet* ndahen në të dhëna parësore e dytësore.

7. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mëposhtme:

a) Plani vjetor analitik i projekteve për vitin pasardhës;

b) Kodi identifikues i projektaktit;

c) Emërtimi i projektaktit;

ç) Dokumente bazë të projektaktit (projektakti, anekse, protokolle, shtojca, formularë etj.);

d) Dokumente shoqëruese (relacion, komunikatë, harta etj.);

dh) Kërkesa për mendim e titullarit të institucionit, e firmosur elektronikisht;

e) Përgjigjja e kërkesës për mendim e firmosur elektronikisht;

ë) Numër protokolli dalës/hyrës;

f) Statusi i projektaktit;

g) Kodi identifikues i mbledhjes së Këshillit të Ministrave;

gj) Statusi i mbledhjes së Këshillit të Ministrave;

h) Rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit të Ministrave;

i) Statusi i rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit të Ministrave.

8. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore, që mund të ndërveprojë me *e-aktet*, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.

9. Dhënës të informacionit për *e-aktet* janë institucionet propozuese dhe mendimdhënëse, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

10. Niveli i aksesit në *e-aktet* është, si më poshtë vijon:

a) Këshilli i Ministrave ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave në rolin:

i. “Administrator i bazës së të dhënave”.

b) Përdoruesi i autorizuar nga institucionet propozuese/mendimdhënëse dhe Këshilli i Ministrave:

i. Koordinator iniciues, që fillon procedurën për projektaktin;

ii. Punonjësit, që kryejnë në sistem procedurat e hartimit, përgatitjes dhe miratimit së brendshmi të projektaktit apo të mendimit për të, në aparatin e ministrisë apo të institucionit të varësisë;

iii. Sekretar i Përgjithshëm institucioni, që miraton;

iv. Titullari i institucionit, që dërgon për mendim ose për miratim në Këshillin e Ministrave dhe kthen përgjigje;

v. Përdorues, vetëm lexues pranë Kryeministrit, ministrit të Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit);

vi. Koordinator institucioni mendimdhënës;

vii. Protokolli/arkivi;

viii. Jurist në Kryeministri;

ix. Redaktor;

x. Drejtori i strukturës/ave përgjegjëse për aktet, në Kryeministri;

xi. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, zëvendësi i tij ose punonjësi, të cilit i janë deleguar kompetencat e tij.

11. Secila etapë e procedurave të lidhura me projektaktin apo dhënien e mendimit për të përmbyllet nga punonjësi përgjegjës në ministri,



sipas funksionit të tij, duke shoqëruar veprimin e tij në sistem me nënshkrimin elektronik.

12. Sistemi garanton në çdo rast ruajtjen e historikut të gjendjes së projektaktit dhe praktikës shoqëruese të tij, në momentin kohor të dhënë, të çdo etape procedurale.

13. Të gjitha ndërveprimet e ministrave dhe të institucioneve të varësisë në *e-aktet*, ndërmjet tyre apo me Këshillin e Ministrave, për dërgimin e projektaktit për mendim apo për shqyrtim regjistrohen në sistem nëpërmjet numrit të protokollit, i cili korrespondon me atë në variantin *hard copy*.

14. Kryeministri miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave *e-aktet*, në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

15. Dokumentet e krijuara dhe/ose të ngarkuara në sistemin elektronik të *e-aktet*, që prej fillimit të funksionimit të këtij sistemi, konsiderohen pjesë e dokumentacionit të projektaktit. Ky rregull zbatohet për të gjitha dokumentet, që janë ngarkuar në këtë sistem nga organet kompetente, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, duke përfshirë dokumentet elektronike, që përmbajnë nënshkrimin elektronik apo vulën elektronike, dokumentet e tjera në format elektronik, që nuk i përmbajnë këto elemente, si dhe dokumentet që ngarkohen si kopje e një dokumenti shkresor *hard copy* të vlefshëm, të krijuar jashtë sistemit. Këto dokumente, në rast nevojë të arkivimit dhe/ose të shpërndarjes e shfrytëzimit në format shkresor *hard copy* nga të tretë, pas printimit shoqërohen me vulën e institucionit ose me elemente të tjera teknologjike të autentifikimit, si: *barcode*, kode QR etj.

16. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për të hartuar rregulloren e parashikuar në pikën 14 të këtij vendimi dhe për t’ia paraqitur atë për miratim Kryeministrit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 730, datë 27.11.2024

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministër i Financave, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 736, datë 27.11.2024

PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE PËR FESTAT E FUNDVITIT 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr.



7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

c) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfutues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

ç) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfutues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar, si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, ‘Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar’”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

dh) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nuk janë të punësuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

e) Personat që përfitojnë pension, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

ë) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar;

f) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet

mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

g) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

2. Shpërblimin, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie, me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, mbi masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

c) Personat që përfitojnë pension, me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

ç) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë;

d) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;



dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm, të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) Personat që nuk përfitojnë pension sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar, të caktuar sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

ë) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve, që kanë punuar në metalurgji”, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë.

3. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që kanë datë të fillimit të përfitimit, deri në datën 31.12.2024, duke përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë të marrin vetëm një herë këtë shpërblim pavarësisht se mund të përfitojnë më shumë se një përfitim.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 9 873 862 000 (nëntë miliardë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë, e ndarë në 9 805 225 000 (nëntë miliardë e tetëqind e pesë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë për shpërblimin dhe 68 637 000 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit.

5. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2024 dhe paguhet

gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2024, ato paguhet deri në datën 30.6.2025. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen pas datës 30.6.2025.

6. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura, që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

7. Efektet financiare, prej 9 873 862 000 (nëntë miliardë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekësh, përballohen, si më poshtë vijon:

a) në masën 3 650 000 000 (tre miliardë e gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, nga fondi “Kontingjencë për bonusin e pensionistëve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;

b) në masën 2 444 000 000 (dy miliardë e katërqind e dyzet e katër milionë) lekë, nga fondi “Për indeksimin e pensioneve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;

c) në masën 3 779 862 000 (tre miliardë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, nga buxheti i shtetit dhe buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore, për vitin 2024”.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë

